



- [Lajme](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sport](#)
- [Magazina](#)
- [Femra](#)
- [Stili](#)
- [Shendetesi](#)
- [Kuzhina](#)
- [Auto](#)
- [Teknologji](#)
- [Fun](#)
- [FunZone](#)

0 Shkepje

Tregu zivceran i mirëpret produktet e Elnor, Lesna dhe Shehu (Foto)

Më Shumë

21° C Prishtinë

- [RTV Dukagjini](#)
- [Smardonline](#)
- [Kërko Punë](#)
- [Marketing](#)
- [Arkiva](#)



Ekonomi / [Ekonomi](#)

Tregu zivceran i mirëpret produktet e Elnor, Lesna dhe Shehu (Foto)

3 muaj më parë

0 Shkepje



Kualiteti i kompanive vendore sa i përket industrisë së përpunimit të drurit është i nivelit të kënaqshëm. Së paku kështu mendojnë Zvicranët, vizitorë të shumtë te panairit më të madh tregtarë SwissBau në Basel te Zvicrës.

Kompanitë kosovare Elnor, Lesna, dhe Shehu janë duke prezantuar produktet e tyre në këtë panair me dizajnë dhe çmime konkurruese në tregun e eksporteve.



Menaxheri i prodhimit nga kompani Lesna, Albinot Mahmuti, tha se fillimi i panairit duket mjaft i suksesshem, sepse ka mjaft vizitorë, sidomos shqiptarë që punojnë këtu. Për produktet tona interesohen më së shumti ndërtimtarët, dhe arkitektët te cilet presin kftera nga ne.



Përfaqësuesja e shoqatës së përpunuesve të drurit, Arieta Vula Pozhegu, njëherit bashkorganizatorë të kësaj pjesëmarrje, shpjegoj për mediat Zvicerane historinë e industrisë së drurit të Kosovës, dhe tentativat e shtytjet e tanishme për të rifilluar eksportin, sepse Kosova ka traditë dhe fuqi punëtore të bollshme për t'i përmbushur kërkesat.



Sheqer Ukaj, pronar i firmës Elnor, shpjegoi se produktet i transportuan deri këtu nga Kosova, dhe se interesimi është i madh. Ai gjithashtu shprehu se do të jenë në panair deri në mbyllje nga data 16 Janar 2016, ku edhe pritet vizita e ambasadorit të Kosovës në Zvicër z.Mustafë Xhemajli së bashku me Kryetarin e Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Zvicër z.Naser Mustafa.



Kreshnik Shehu, pronar i NTP Shehu, shprehu se gjithmonë është e nevojshme të marrësh pjesë me produkte. Produktet i kemi plasuar që 3-4 vite në tregun Zvicëran, me kualitet dhe garancion. Mirëpo kemi nevojë me u pa se kemi produkte alternative me çmime më të mira se këtu. Pas panairit do ti kryejmë porositë të cilat i kemi bërë sa ishim këtu, dhe ku mund të them se kemi pasur mjaft sukses.



Pjesëmarrja në këtë panair u bë e mundur nga mbështetja e përbashkët nga projekti PPSE-Swisscontact, USAID Empower, dhe Agjencioni për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve KIESA.



TELEGRAFI sh.p.k. Rr. Bajram Kelmendi Nr.35, Prishtinë, Kosovë info@telegrafi.com 038-224-093 Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2006-2016 Portali Telegrafi

- [Privacy policy](#)